

Personal Preparation to Meet the Savior

By Elder Dale G. Renlund
Of the Quorum of the Twelve Apostles

Përgatitja Vetjake për të Takuar Shpëtimtarin

Nga Plaku Dejjl G. Renland,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

April 2025 general conference

Follow the Savior's teachings. His instructions are neither mysterious nor complex. When we follow them, we do not need to fear or be anxious.

My dear brothers and sisters, last October, President Russell M. Nelson taught, “Now is the time for you and for me to prepare for the Second Coming of our Lord and Savior, Jesus the Christ.” When President Nelson speaks about the Second Coming, it is always with joyful optimism. However, a girl in Primary recently told me that she becomes anxious whenever the Second Coming is mentioned. She said, “I’m scared because bad things are going to happen before Jesus comes again.”

It is not just children who may feel this way. The best advice for her, for you, and for me is to follow the Savior’s teachings. His instructions are neither mysterious nor complex. When we follow them, we do not need to fear or be anxious.

Toward the end of His mortal ministry, Jesus Christ was asked when He would come again. In answering, He taught three parables, recorded in Matthew 25, about how to prepare to meet Him—whether at His Second Coming or whenever we leave this world. These teachings are crucial because personal preparation to meet Him is central to life’s purpose.

The Savior first told the parable of the ten virgins. In this parable, ten virgins went to a wedding feast. Five wisely brought oil to fill their lamps, and five foolishly did not. When the bridegroom’s imminent arrival was announced, the foolish virgins left to buy oil. When they

Ndiqini mësimet e Shpëtimtarit. Udhëzimet e Tij nuk janë as të mistershme, as të ndërlikuara. Kur i ndjekim ato, nuk ka pse të kemi frikë ose të na zërë ankthi.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, tetorin e kaluar, Presidenti Rasëll M. Nelson dha mësim: “Tani është koha që ju dhe unë të përgatitemi për Ardhjen e Dytë të Zotit dhe Shpëtimtarit tonë, Jezusit, Krishtit”. Kur Presidenti Nelson flet rreth Ardhjes së Dytë, këtë e bën gjithnjë me optimizëm plot gëzim. Megjithatë, një vajzë në Filllore më tha së fundmi se e zë ankthi sa herë që përmendet Ardhja e Dytë. Ajo tha: “Frikësohem sepse do të ndodhin gjëra të këqija përpara se Jezusi të vijë përsëri”.

Fëmijët nuk janë të vetmit që mund të ndihen kështu. Këshilla më e mirë për të, për ju dhe për mua është të ndjekim mësimet e Shpëtimtarit. Udhëzimet e Tij nuk janë as të mistershme, as të ndërlikuara. Kur i ndjekim ato, nuk ka pse të kemi frikë ose të na zërë ankthi.

Nga fundi i shërbesës së Tij në vdekshmëri, Jezu Krishtin e pyetën se kur do të vinte përsëri. Në përgjigje, Ai dha mësim tri shëmbëlltyra, të shënuara te Mateu 25, për mënyrën se si të përgatitemi për ta takuar Atë, qoftë në Ardhjen e Tij të Dytë, apo kurdo që të ndahemi nga kjo botë. Këto mësimet janë vendimtare sepse përgatitja vetjake për ta takuar Atë është qendrore për qëllimin e jetës.

Shpëtimtari fillimisht tregoi shëmbëlltyrën e dhjetë virgjërëshave. Në këtë shëmbëlltyrë, dhjetë virgjërësha shkuan në një gosti dasme. Pesë të mençurat e morën me vete vajin për të mbushur llambat e tyre dhe pesë budallaçkat nuk e morën. Kur u njoftua ardhja e afërt e dhëndrit,

returned, it was too late; the door to the feast was shut.

Jesus identified three aspects of the parable to help us. He explained:

“And at that day, when I shall come in my glory, shall the parable be fulfilled which I spake concerning the ten virgins.

“For they that are wise and have received the truth, and have taken the Holy Spirit for their guide, and have not been deceived—verily I say unto you, they shall ... abide the day.”

In other words, they did not need to fear or be anxious, because they would survive and prosper. They would prevail.

If we are wise, we receive the truth by accepting the gospel of Jesus Christ through priesthood ordinances and covenants. Next, we strive to remain worthy of having the Holy Ghost always with us. This capability must be acquired individually and personally, drop by drop. Consistent, personal, private acts of devotion invite the Holy Ghost to guide us.

The third element that Jesus highlighted is avoiding deception. The Savior warned:

“Take heed that no man deceive you.

“For many shall come in my name, saying, I am Christ; and shall deceive many.”

The Savior knew pretenders would try to deceive the very elect and that many disciples would be duped. We should neither believe those who falsely claim divine sanction nor venture into metaphorical deserts or secret chambers to be taught by counterfeits.

The Book of Mormon teaches us how we can differentiate deceivers from disciples. Disciples always promote believing in God, serving Him, and doing good. We will not be deceived when we seek and take counsel from trusted individuals who are themselves faithful disciples of the Savior.

We can also avoid deception by worshipping regularly in the temple. This helps us maintain an eternal perspective and protects us from influences that might distract or divert us from the covenant path.

virgjërshat budallaçka ikën për të blerë vaj. Kur u kthyen, ishte tepër vonë; dera për në gosti ishte mbyllur.

Jezusi përcaktoi tri aspekte të shëmbëlltyrës për të na ndihmuar. Ai shpjegoi:

“Dhe në atë ditë, kur unë të vij në lavdinë time, do të përmbushet shëmbëlltyra që thashë lidhur me dhjetë virgjërshat.

Sepse ata që janë të urtë dhe e kanë pranuar të vërtetën, dhe kanë marrë Shpirtin e Shenjtë si udhëzuesin e tyre, dhe nuk janë mashtruar – në të vërtetë unë ju them, ata ... do t'i qëndrojnë ditës.”

Me fjalë të tjera, nuk u duhej të kishin frikë ose t'i zinte ankthi sepse ata do të mbijetonin dhe do të përparonin. Ata do të triumfonin.

Nëse jemi të mençur, ne e marrim të vërtetën duke e pranuar ungjillin e Jezu Krishtit nëpërmjet ordinancave të priftërisë dhe besëlidhjeve. Më pas, bëjmë çmos për të qëndruar të denjë për pasjen e Frymës së Shenjtë gjithnjë me ne. Kjo aftësi duhet të fitohet individualisht dhe personalisht, hap pas hapi. Veprat e vazhdueshme, vetjake dhe private të përkushtimit e ftojnë Frymën e Shenjtë të na udhërrëfjë.

Elementi i tretë që Jezusi e theksoi, është shmangia e mashtrimit. Shpëtimtari paralajmëroi:

“Ruhuni se mos ju mashtron ndokush!

Sepse shumë do të vijnë në emrin tim, duke thënë: ‘Unë jam Krishti’ dhe do të mashtrojnë shumë nj[e]rëz.”

Shpëtimtari e dinte se këta shtirakë do të përpiqeshin t'i mashtronin edhe të zgjedhurit dhe se shumë dishepuj do të binin pre. Ne nuk duhet as t'u besojmë atyre që pretendojnë në mënyrë të rreme se kanë miratimin hyjnor, as të shkojmë kuturu pas shkretëtirave apo dhomave të fshehta metaforike për të marrë mësim nga falsifikuesit.

Libri i Mormonit na mëson se si mund të bëjmë dallimin mes mashtruesve dhe dishepujve. Dishepujt nxitin gjithnjë besimin te Perëndia, shërbimin ndaj Tij dhe bërjen mirë. Ne nuk do të mashtrohemi kur kërkojmë dhe marrim këshillë nga individë të besuar që janë vetë dishepuj besnikë të Shpëtimtarit.

Ne mund ta shmangim mashtrimin gjithashtu duke adhuruar rregullisht në tempull. Kjo na ndihmon të ruajmë një këndvështrim të përjetshëm dhe na mbron nga ndikimet që mund të na shpërqendrojnë ose devijojnë nga shtegu i

The essential lesson of this parable of the ten virgins is that we are wise when we accept the gospel, seek to have the Holy Ghost with us, and avoid deception. The five wise virgins could not help those without oil; no one can accept the gospel, take the Holy Ghost as a guide, and avoid deception on our behalf. We have to do this for ourselves.

The Savior then told the parable of the talents. In this parable, a man gave differing amounts of money, referred to as talents, to three servants. To one servant he gave five talents, to another he gave two, and to a third he gave one. Over time, the first two servants doubled what they had received. But the third servant simply buried his single talent. To both servants who had doubled their talents, the man said, "Well done, ... good and faithful servant: thou hast been faithful over a few things, I will make thee ruler over many things: enter thou into the joy of thy lord."

The man then chided the servant who had buried his talent for being "wicked and slothful." This servant's talent was taken away, and he was banished. Yet, had this servant doubled his talent, he would have received the same commendation and reward as the other servants.

One message of this parable is that God expects us to magnify the abilities we have been given, but He does not want us to compare our abilities to those of others. Consider this insight provided by the 18th-century Hasidic scholar Zusya of Anipol. Zusya was a renowned teacher who began to fear as he approached death. His disciples asked, "Master, why do you tremble? You've lived a good life; surely God will grant you a great reward."

Zusya said: "If God says to me, 'Zusya, why were you not another Moses?' I will say, 'Because you didn't give me the greatness of soul that you gave Moses.' And if I stand before God and He says, 'Zusya, why were you not another Solomon?' I will say, 'Because you didn't give me the wisdom of Solomon.' But, alas, what will I say if I stand before my Maker and He says, 'Zusya, why were you not Zusya? Why were you not the man I gave you the capacity to be?' Ah, that is why I

besëlidhjeve.

Mësimi thelbësor i kësaj shëmbëlltyre të dhjetë virgjërëshave, është se ne jemi të mençur kur e pranojmë ungjillin, kur përpiqemi të kemi Frymën e Shenjtë me vete dhe kur e shmangim mashtrimin. Pesë virgjërëshat e mençura nuk mund t'i ndihmonin dot ato që nuk kishin vaj; askush nuk mund ta pranojë ungjillin, ta marrë Frymën e Shenjtë si udhërrëfyes dhe ta shmangë mashtrimin në vendin tonë. Këtë duhet ta bëjmë vetë për veten tonë.

Shpëtimtari më pas tregoi shëmbëlltyrën e talentave. Në këtë shëmbëlltyrë, një njeri u dha shuma të ndryshme parash, të quajtura talenta, tre shërbëtorëve. Njërit prej shërbëtorëve i dha pesë talenta, një tjetri dy dhe të tretit i dha një. Me kalimin e kohës, dy shërbëtorët e parë e dyfishuan atë që kishin marrë. Kurse shërbëtori i tretë thjesht e groposi talentin e vetëm që kishte. Të dy shërbëtorëve që i kishin dyfishuar talentat e tyre, burri u tha: "Të lumtë, shërbëtor i mirë dhe besnik; ti u tregove besnik në gjëra të vogla, unë do të të vë mbi shumë gjëra; hyr në gëzimin e zotit tënd".

Pastaj burri e qortoi shërbëtorin që e kishte propozur talentin e tij ngaqë qe treguar "i mbrapshtë dhe përtac". Këtij shërbëtori iu mor mbrapsht talenti dhe ai u dëbua. Sidoqoftë, sikur shërbëtori ta kishte dyfishuar talentin e tij, ai do të kishte marrë të njëjtin përgëzim dhe shpërblim si shërbëtorët e tjerë.

Një mesazh i kësaj shëmbëlltyre është se Perëndia pret nga ne që t'i shumëfishojmë aftësitë që na janë dhënë, mirëpo Ai nuk do që ne t'i krahasojmë aftësitë tona me ato të të tjerëve. Merrni parasysh këtë këndvështrim që na u dha nga studiuesi hasidik i shekullit të 18-të, Zusia nga Anipoli. Zusia ishte një mësues me emër, të cilin filloi ta zinte frika ndërsa i afrohej vdekjes. Dishepujt e tij e pyetën: "Mësues, pse drithërohesh? Ti ke bërë një jetë të mirë; me siguri, Perëndia do të të japë një shpërblim të madh."

Zusia tha: "Nëse Perëndia më thotë: 'Zusia, pse nuk ishe ti një Moisi tjetër?' Do t'i them: 'Sepse nuk më dhe madhëstini e shpirtit që ia dhe Moisiut'. Dhe po të qëndroj para Perëndisë dhe Ai të thotë: 'Zusia, pse nuk ishe ti një Salomon tjetër?' Do t'i them: 'Sepse nuk më dhe urtësinë e Salomonit'. Por, ç'të them unë i mjeri po të qëndroj para krijuesit tim dhe ai të thotë: 'Zusia, pse nuk ishe ti Zusia? Pse nuk ishe ai burrë që të dhashë aftësinë të ishe?' Ah, ja, prandaj

tremble.”

Indeed, God will be disappointed if we do not rely upon the merits, mercy, and grace of the Savior to magnify the God-given abilities we have received. With His loving assistance, He expects us to become the best version of ourselves. That we may start with differing abilities is irrelevant to Him. And it should be to us.

Finally, the Savior told the parable of the sheep and goats. When He returns in His glory, “before him shall be gathered all nations: and he shall separate them one from another, as a shepherd divideth his sheep from the goats: and he shall set the sheep on his right hand, but the goats on the left.”

Those on His right became heirs in His kingdom, and those on His left received no inheritance. The distinguishing characteristic was whether they fed Him when He was hungry, gave Him drink when He was thirsty, housed Him when He was a stranger, clothed Him when He was naked, and visited Him when He was sick or imprisoned.

Everyone was perplexed, both those on the right hand and those on the left hand. They asked when they had, or when they had not, given Him food, drink, and clothing or helped Him when He was vulnerable. In response, the Savior said, “Verily I say unto you, Inasmuch as ye have done it unto one of the least of these my brethren, ye have done it unto me.”

The message of the parable is clear: when we serve others, we serve God; when we don't, we disappoint. He expects us to use our gifts, talents, and abilities to bless the lives of Heavenly Father's children. The divine impulse to serve others is illustrated in a poem written in the 19th century by the Finnish poet Johan Ludvig Runeberg. My siblings and I repeatedly heard the poem “Farmer Paavo” throughout our childhoods. In the poem, Paavo was a poor farmer who lived with his wife and children in the lake region of central Finland. Several years in a row, most of his crops were destroyed, whether through the runoff from the spring snowmelt, summer hailstorms, or an early autumn frost. Each time the meager harvest came in, the farmer's wife lamented, “Paavo, Paavo, you unfortunate old man, God has forsaken us.” Paavo, in turn, stoically said, “Mix bark with the rye flour to make bread so the children won't go hungry. I'll work harder to drain the marshy

drithërohem.”

Në të vërtetë, Perëndia do të zhgënjehet nëse nuk mbështetemi te meritat, mëshira dhe hiri i Shpëtimtarit për t'i shumëfishuar aftësitë që i kemi marrë prej Perëndisë. Me ndihmën e Tij të përzemërt, Ai pret që ne të bëhemi varianti më i mirë i vetes. Fakti që mund ta nisim jetën me aftësi të ndryshme është e parëndësishme për Të. Ashtu duhet të jetë edhe për ne.

Së fundmi, Shpëtimtari tregoi shëmbëlltyrën e deleve dhe cjepte. Kur Ai të kthehet në lavdinë e Tij, “të gjithë[a] kombet do të mbledhen para tij; dhe ai do ta ndajë njërin nga tjetri ashtu si i ndan bariu delet nga cjeptë. Dhe delet do t'i vërë në të djathtën e tij dhe cjeptë në të majtën.”

Ata që ishin në të djathtën e Tij, u bënë trashëgimtarë në mbretërinë e Tij dhe ata që ishin në të majtën e Tij, nuk morën trashëgimi. Karakteristika dalluese ishte fakti a e ushqyen Atë kur ishte i uritur, a i dhanë për të pirë kur kishte etje, a e strehuan kur ishte i huaj, a e veshën kur ishte i zhveshur dhe a e vizituan kur ishte i sëmurë apo në burg.

Të gjithë ishin të pështjelluar, si ata në krah të djathtë, edhe ata në krah të majtë. Ata e pyetën se kur i kishin dhënë apo nuk i kishin dhënë ushqim, pije, veshje ose ndihmë kur Ai ishte i pamundur. Në përgjigje, Shpëtimtari tha: “Në të vërtetë po ju them: sa herë ia keni bërë këtë ndonjërit prej këtyre vëllezërve të mi më të vegjël, këtë ma bëtë mua”.

Mesazhi i shëmbëlltyrës është i qartë: Kur u shërbejmë të tjerëve, ne i shërbejmë Perëndisë; kur nuk u shërbejmë, ne e zhgënjëjmë Atë. Ai pret që ne t'i përdorim dhuratat, talentet dhe aftësitë tona për të bekuar jetët e fëmijëve të Atit Qiellor. Impulsi hyjnor për t'u shërbyer të tjerëve, ilustrohet në një poemë të shkruar në shekullin e 19-të nga poeti finlandez, Johan Ludvig Runeberg. Unë dhe vëllezërit e motrat e mia e kemi dëgjuar vazhdimisht poemën “Bujku Pavo”, gjatë gjithë fëmijërisë sonë. Në poemë, Pavoja ishte një bujk i varfër që jetonte me të shoqen dhe fëmijët e tij në rajonin liqenor të Finlandës qendrore. Disa vjet radhazi, pjesa më e madhe e të korrave i prishej, qoftë nga përmytja prej shkrirjes së dëborës në pranverë, nga stuhitë e breshrit në verë apo nga ngricat e parakohshme të vjeshtës. Sa herë që vinte koha e të korrave të pakta, gruaja e bujkut qahej: “Pavo, Pavo, more plak i gjorë, na ka braktisur Perëndia”. Pavoja, nga ana tjetër,

fields. God is testing us, but He will provide.”

Each time the crops were destroyed, Paavo directed his wife to double the amount of bark that she mixed into the flour to ward off starvation. He also worked harder, digging trenches to drain the ground and decrease his fields’ susceptibility to a spring runoff and an early autumn frost.

After years of hardship, Paavo finally harvested a rich crop. His wife exulted, “Paavo, Paavo, these are happy times! It is time to throw away the bark, and bake bread made only with rye.” But Paavo solemnly took his wife’s hand and said, “Mix half the flour with bark, for our neighbor’s fields have frosted over.” Paavo sacrificed his and his family’s bounty to help his devastated and destitute neighbor.

The lesson of the Savior’s parable of the sheep and goats is that we are to use the gifts we have been given—time, talents, and blessings—to serve Heavenly Father’s children, especially the most vulnerable and needy.

My invitation to the anxious Primary child I mentioned earlier, and to each of you, is to follow Jesus Christ and to trust the Holy Ghost as you would a cherished friend. Rely on those who love you and who love the Savior. Seek God’s guidance to develop your unique abilities, and help others, even when it isn’t easy. You will be ready to meet the Savior, and you can join President Nelson in being joyfully optimistic. In doing so, you help the world prepare for the Second Coming of Jesus Christ, and you will be blessed with sufficient hope to enter the rest and joy of the Lord, now and in the future.

As we sing in one of our new hymns:

Rejoice! And prepare for that day! ...

No one knows the day and hour when He will come again,

But He’ll return as scriptures say; it will be a joyful day

thoshte në mënyrë stoike: “Përziej lëvore me miell thekre për të bërë bukë që të mos kenë uri fëmijët. Unë do të punoj më fort për të kulluar fushat që i ka zënë uji. Perëndia po na sprovon, por Ai do të na e sigurojë atë që na duhet.”

Sa herë që prisheshin të korrat, Pavoja e udhëzonte të shoqen që ta dyfishonte sasinë e lëvres që përziente me miellin për të shmangur urinë prej zisë së bukës. Ai gjithashtu punonte fort, duke hapur kanale që të kullonte tokën dhe që ta ulte dëmin e mundshëm në fushat e tij nga shkrirja e dëborës në pranverë dhe ngricat e parakohshme të vjeshtës.

Pas shumë vitesh mundimi, Pavoja më në fund mblodhi të korra me bollëk. E shoqja me ngazëllim tha: “Pavo, Pavo, ç’kohë e gëzuar është kjo! Është koha ta hedhim lëvoren dhe ta bëjmë bukën vetëm me thekër.” Mirëpo Pavoja, e kapi me fisnikëri të shoqen nga dora dhe i tha: “Përzije gjysmën e miellit me lëvore, sepse fushat e fqinjit tonë i ka zënë ngrica”. Pavoja sakrifiko bollëkun e vet dhe të familjes së tij për të ndihmuar fqinjin e tij të mbetur shkretë e të vobektë.

Mësimi i shëmbëlltyrës së Shpëtimtarit të deleve dhe cjepve është që ne duhet t’i përdorim dhuratat që na janë dhënë, kohën, talentet dhe bekimet, për t’u shërbyer fëmijëve të Atit Qielor, veçanërisht atyre më të cënueshëm dhe më nevojtarë.

Ftesa ime ndaj fëmijës së Fillores në ankth që e përmenda më herët, dhe secilit prej jush, është që të ndiqni Jezu Krishtin dhe t’i mirëbesoni Frymës së Shenjtë siç do t’i besoni një miku të dashur. Mbështetuni tek ata që ju duan dhe që e duan Shpëtimtarin. Kërkojeni udhërrëfimin e Perëndisë për të zhvilluar aftësitë tuaja të pashoqe dhe për të ndihmuar të tjerët, edhe kur nuk është e lehtë. Ju do të jeni gati për ta takuar Shpëtimtarin dhe mund t’i bashkoheni Presidentit Nelson duke qenë optimistë plot gëzim. Kur e bëni këtë, ju ndihmoni ta përgatitni botën për Ardhjen e Dytë të Jezu Krishtit dhe do të bekohe- ni me shpresë të mjaftueshme për të hyrë në pre- hjen dhe gëzimin e Zotit, tani dhe në të ardhmen.

Sikurse këndojmë në njërin nga himnet tona të reja:

“G’zohuni! Përgatituni për atë ditë! ...

Ditën dhe orën kush s’e di, kur Ai sërish do t’vij,

Shkrimet thon, Ai do t’kthehet; g’zim atë ditë do t’ket’

When our beloved Savior comes again.
In the name of Jesus Christ, amen.

Kur Shpëtimtari ynë i dashur sërish të vij”
Në emrin e Jezu Krishtit, amen.